



Për sa më sipër, ju rikujtojmë se një nga gjetjet e identifikuar gjatë hetimit të pavarur administrativ, të kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit, konsiston në thyerjen dhe cenimin e besimit, ndërmjet palëve punëdhënës dhe punëmarrës, e cila ka shkaktuar një raport konfliktual në mjediset e kësaj shkolle. Lidhur me këtë situatë, janë vënë në dijeni nga të dyja palët në konflikt, institucionet përgjegjëse si; Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë dhe Inspektorati Shtetëror Arsimor, të cilët kanë ushtruar kontrole të herëpashershme, por nuk kanë gjetur zgjidhje të këtij problemi. Nxënësit e kësaj shkolle, janë pyetur mbi ngjarjet dhe konfliktet e krijuara dhe kjo situatë ka sjellë përkeqësimin e gjendjes së tyre psikologjike dhe për të cilën kanë marrë shërbime psikologjike të ofruara nga Shoqata “Alo 116”, si edhe privatisht.

Në mbështetje të pikë 5, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara.

Për një fillim sa më të mbarë të vitit shkollor, në mënyrë që edukimi i fëmijëve të kryhet në një mjedis të qetë, duke garantuar të drejtën e tyre për t’u arsimuar, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës, në zbatim të neneve 18 e 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, kërkojmë zbatimin në mënyrë korrekte të rekomandimit nr. K5/NJ1-10, datë 8.5.2018, të Avokatit të Popullit.

Në përputhje me nenin 23, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, Avokati i Popullit nëse nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ka të drejtë ta ndjekë çështjen te organi më i lartë në hierarki.

Bashkëlidhur, gjeni një kopje të rekomandimit nr. K5/NJ1-10, datë 8.5.2018.

Për, sa më sipër, lutemi në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

**AVOKAT I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**